



Komuna e Strugës



UNDP-Agjensioni
për Zhvillim Lokal-
Strugë

**STRATEGJIA PËR ZHVILLIM TË
QËNDRUESHËM
2007-2011
NË KOMUNËN E STRUGËS**

Strugë, Maj 2007



Përpunimi dhe botimi i Strategjisë për zhvillim dhe qëndrueshmëri janë për-krahur nga programi për zhvillim I Kombeve të Bashkuara – UNDP , e finansuar nga qeveria e Finlandes

E Përgatitën

Ekipi lokal për zhvillim të qëndrueshëm të Komunës së Strugës

Lektor

Violeta Tanceva Zlateva

Dizajni, dhe botimi

Apolo Images

ISBN 978-9989-188-17-6

Projekti

**Qeverisje Lokale për Zhvillim të Qëndrueshëm Njerëzor dhe Ekonomik
MCD/00013527**

Address: Nikola Vapcarov 2/4-4, 1000 Skopje

Tel: (389 2) 32 44 108

UNDP Project Team

Sofija Gramatova Ristovska

Irena Micajkova

Dimce Damjanovski

Jasminka Popovska

Katerina Vasileska

Genci Muharemi

Gjoko Mileski

Qendrimet e dhena ne kete dokument jane qendrimet e autoreve dhe ne te njejten kohe nuk jane qendrimet e Programit per zhvillim te Kombeve te Bashkuara ose Sekretarijtit te Kombeve te Bashkuara ne lidhje me statusin juridik dhe emrin e kujtdo vendi tjetër, teritori, qyteti ose te autoreve te ketij teksti.

A. Pasqyrim i Strategjisë	5
A.1. Prioritetet kryesore	5
A.2. Temat kryesore dhe qëllimet	6
A.3. Plane për veprim, kryerje dhe implementim	7
A.4. Vizioni	7
Hyrje	9
Procesi i formulimit të strategjisë	10
I PJESA E PARË - VLERESIMI LOKAL	
1. Pjes-vlersimi lokal	11
1.1. Të dhënat e përgjithshme	12
1.1.1. Pozita Gjeografike	12
1.1.2. Klima	12
1.1.3. Resurset Natyrore	13
1.1.4. Popullata	14
1.1.5. Ambienti Jetesor	16
1.2. Ekonomia	16
1.2.1. Numri dhe struktura e subjekteve afariste	17
1.2.2. Fuqia puntore, punësimi dhe papunisia	18
1.2.3. Përshkrim i sektorëve ekonomikë sipërfaqësorë	19
1.2.4. Infrastruktura	25
1.3. Profili social	27
1.3.1. Arsimi	27
1.3.2. Shëndetësia dhe mbrojtja sociale	27
1.3.3. Kultura	28
1.3.4. Soprt	29
1.3.5. Sektori I OJQ-ve	29
1.3.6. Mediumet	30
1.4. Zhvillim Rural	30
1.5. Bashkëpunimi Regjional	30
1.6. Kompetencat e Komunës	30
2. SWOT	33

Përmbajtja

II PJESA E PARË - Pjesët e Strategjis

Vizioni	41
Infrastruktura	42
Kualiteti i jetës	44
Zhvillimi socio-ekonomik	46
Arsim dhe trajnim	49

III PJESA E PARË - Plan Aksional

Hyrje	52
Projekte prioritare: Infrastruktura	55
Projekte prioritare: Kualiteti i jetës	68
Projekte prioritare: Zhvillimi socio-ekonomik	76
Projekte prioritare: Arsim dhe trajnim	81
Infrastruktura	87
Kualiteti i jetës	104
Zhvillimi socio-ekonomik	117
Arsim dhe trajnim	124

A Pasqyrë e strategjisë

Nga korriku i vitit 2005 deri në korrik të 2006-ës në Komunën e Strugës qe inicuar procesi i Planifikimit Strategjik që të ndërtohet një bazë për zhvillimin e saj të ardhshëm. Ky proces i përkrahur financiarisht nga Qeveria e Finlandës, u përkrah nga Agjencioni Lokal për Zhvillim (ALZH) në kuadër të projektit të UNDP-së i udhëhequr nga ekip ekspertësh të jashtëm. ALZH organizoi konsultime të gjera me biznes grupe lokale si dhe grupe të tjera shoqërore nga sfera të ndryshme të cilët i shfaqën temat dhe prioritetet në Komunën e Strugës, të cilave duhet tu kushtohet kujdes. Strategjia përfshin :

- Vlerësim të rrjedhave ekonomike, shoqërore dhe të gjendjes kulturore në komunë (pjesa I),
- SWOT Analiza (pjesa II)
- Plani Strategjik për Zhvillim (pjesa III) dhe
- Planin Aksional (pjesa e IV)

A.1. Prioritetet kryesore

Sfida kryesore zhvillimore me të cilat do të duhet të ballafaqohet decentralizimi qeveritar dhe grupet e tyre partnere në komunë janë më sa vijon:

- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik është i nevojshëm që të sigurohen punësime dhe të rriten të hyrat dhe mundësitë për Strugën. Momentalisht ekonomia ka ekonomizim të gjerë të bazuar dhe të fokusuar mbi sektorë tradicional si në turizëm, industri tekstile, ndërtimtari, pylltari dhe bujqësi. Përderisa të tillat sigurojnë bazë të mire për zhvillim, i nevojshëm është përparim i vërtetë që të përmirësohet konkurrenca në të gjithë sektorët dhe të përhapet baza ekonomike.
- Arsimimi dhe përgatitja permanente (kualifikimi) do të jenë nxitësit kryesor të zhvillimit të komunës. Edhe pse aktualisht ka qasje të kufizuara të dhënave, ekziston nevoja për përshtatje më të mire të nevojës për kualifikim të bizneseve, shërbimeve dhe administratës me kualitet të shtuar dhe zbatim të arsimimit.
- Turizmi ka potencial të rëndësishëm që të bëhet nxitës i zhvillimit. Struga ndodhet pranë Liqenit të bukur të Ohrit, i cili ndodhet pranë dy vendeve

fqinj (Shqipëri dhe Greqi) dhe ka histori të gjatë si regjion për aktivitete kulturore dhe të ngjarjeve historike. Me një planifikim dhe investim të mirë, Struga mund të bëhet qendër e rëndësishme turistike konkurruese në treg .

- Menaxhimi i mirë me resurset natyrore, të cilat mund të gjenden në numër të konsiderueshëm në Strugë, do të jenë të rëndësishme qenësore për zhvillim të qëndrueshëm të komunës. Liqeni i Ohrit, lumenjtë, pyjet, malet, toka bujqësore dhe jobujqësore dhe flora dhe fauna e begatshme janë burimet, të cilët do ta përrrijnë kualitetin e tërësishëm të jetës dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.
- Grupe sektorësh reprezentativ, sektori i OJQ-ve dhe grupe komunale ekzistojnë dhe funksionojnë dhe kanë nevojë për përkrahje dhe ndihmë për zhvillim, me qëllim që të kontribuojnë më shumë si partnerë qenësor në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës. Implementimi i suksesshëm i kësaj strategjie kërkon partneritet të fuqishëm publik, privat dhe komunal.
- Llojshmëria etnike dhe kulturore në Strugë gjithashtu jep një bazë të fuqishme për zhvillimin e ardhshëm, veçanërisht kur Maqedonia dhe Shqipëria fqinje ecin drejt integritimit në UE dhe marrëdhëniet më të përafërta me të gjitha vendet fqinje dhe ato të regjionit. Egzistojnë fusha të ndryshme për bashkëpunim duke përfshirë tregtinë dhe transportin, turizmin, shkëmbimin kulturor, zhvillimin e infrastrukturës dhe mbrojtjen e ambientit jetësor.
- Egzistojnë mangësi serioze në infrastrukturë, të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje. Shumë lartësi në listë janë, menaxhimi me hedhurinat e forta (përfshirë ricklimin) dhe sistemet e kanalizimit si dhe përmisimin e sistemit të ujësjellësit gjithashtu edhe sanimin e rrugëve.
- Me planet e reja strategjike, të cilët shfaqen në nivel nacional, përfshihen një numër i madh i lëmive tematike. Struga duhet të përfshihet në proceset pozitive të konsultimeve në formulimin e këtyre planeve dhe ta harmonizojë zhvillimin e komunës.

A.2. Temat kryesore dhe qëllimet

Strategjia e prezantuar në këtë dokument e përshkruan kornizën në të cilën shqyrtohen temat e paraqitura me lartë. Strategjia është e grupuar në katër lëmi kryesore tematike:

1. Infrastrukturë
2. Zhvillim ekonomik të qëndrueshëm
3. Kualitet I jetës
4. Arsimi dhe përgatitje (kualifikim)

Infrastruktura	Arsimi
<ul style="list-style-type: none"> • Transporti 	<ul style="list-style-type: none"> • Arsimimi dhe edukimi parashkollor
<ul style="list-style-type: none"> • Rrugët 	<ul style="list-style-type: none"> • Programe arsimore për grupe të lënduara (të papunë, mjeshtër, gra, persona me nevoja të posaçme dhe punonjës të falimentimit)
<ul style="list-style-type: none"> • Komunikacioni liqenor 	<ul style="list-style-type: none"> • Sektori qytetar dhe rrjetëzimi
<ul style="list-style-type: none"> • Telekomunikacionet 	<ul style="list-style-type: none"> • Sektori i biznesit dhe arsimit
<ul style="list-style-type: none"> • Energjia 	<ul style="list-style-type: none"> • Këshillimoret
<ul style="list-style-type: none"> • Ujësjellësi dhe kanalizimet 	<ul style="list-style-type: none"> • Të mësuarit e përgjeshëm
<ul style="list-style-type: none"> • Menaxhimi me mbeturinat 	
Kualiteti jetësor	Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik
<ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja shëndetësore 	<ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i përkrahjes së sipërmarrjeve të vogla e të mesme
<ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja sociale 	<ul style="list-style-type: none"> • Sektori i zhvillimit të turizmit
<ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja e qytetarëve 	<ul style="list-style-type: none"> • Bujqësia dhe zhvillimi rural
<ul style="list-style-type: none"> • Mbrojtja e ambientit 	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimi ndërkuftar
<ul style="list-style-type: none"> • Kultura 	<ul style="list-style-type: none"> • Thithja direkte e investimeve të jashtme
<ul style="list-style-type: none"> • Sporti 	
<ul style="list-style-type: none"> • Artet 	
<ul style="list-style-type: none"> • Trashëgimia natyrore 	

Qëllimet kryesore të cilat duhet të arrihen me implementimin e Strategjinë janë:

Planifikim modern urbanistik i organizuar me qëllim që ti kënaqë nevojat e bashkësisë strugane më të sofistikuara dhe progresive.

Sisteme infrastrukturale private dhe publike më të rregulluara dhe shërbime që e perforcojnë zhvillimin afarist dhe zhvillimin e bashkësisë në komunë.

Rrjet të zhvilluar të përkrahjes institucionale e funksionale, qasje dhe veprimtari shërbyese zhvillimore dhe afariste profesionale për bashkësinë.

Struga e zhvillon potencialin e vet që të mund të marrë pjesë në programe investive ndërkombëtare dhe të thithë investime direkte të huaja. (IDH).

Qytetarët janë më aktivë dhe më të aftë të marrin pjesë në zhvillimin e aspekteve të cilësisë së jetës në komunë dhe në të gjitha lëmitë e saja për qark.

Objektet komunale të artit, sportit dhe informimit janë përmirësuar-riparuar dhe shfrytëzimi i tyre është zgjeruar.

Shërbimi shëndetësor siguron dhe ofron mbrojtje të nevojshme shëndetësore për qytetarët e Strugës në mënyrë më efektive dhe më efektive.

Mbrojtja sociale dhe sistemi për mbrojtje të bashkësisë sigurojnë përkrahje të mjaftueshme të qytetarëve të Strugës në mënyrë më efektive dhe më efektive.

Kapaciteti dhe mirëkuptimi drejt nevojës për mbrojtje dhe përforsim të ambientit të natyrës dhe ndërtimtarisë janë përmirësuar.

Arsimi është më i shumëllojshëm, fleksibil dhe i mundshëm dhe dëshmon lidhshmëri më të fuqishme dhe më domethënëse me mundësitë afariste dhe mundësi për punësim në komunë dhe në regjionin më të gjerë.

Grupet e marginalizuara dhe lënduese kanë qasje drejt shërbimeve më të mira dhe sistemeve, që mundësojnë kyçje më të mirë në miratimin e vendimeve dhe zhvillimin e bashkësisë.

A.3. Plani Aksional

Strategjia e ofron kornizën e tërësishme për zhvillim të qëndrueshëm për Strugën në periudhën e viteve 2006-2011. Plani aksional përfshin detaje të rëndësishme për programet dhe projektet, të cilët duhet të implementohen duke përfshirë përshkrimet e detajuara të punës, funksionimin, partnerët e implementimit dhe kryerësit, rezultatet dhe indikatorët e ndikimit, kornizat kohore, parashikimet dhe rreziqet etj.

A.4. Vizioni

Strategjia do të jetë e suksesshme, nëse realizohet vizioni i secilës nga katër temat:

Përmes planifikimit më të mirë urbanistik dhe procesit të menaxhimit, Struga do të ketë infrastrukturë, e cila do të jetë përkatëse dhe e shumëllojshme; komunë e përparuar dhe ambicioze dhe e shumëllojshme dhe do të ketë mundësi të përmbajë zhvillim të qëndrueshëm në bazë të gjerë.

Deri në vitin 2011 Struga do të dëshmon shërim të fuqishëm ekonomik dhe gjallëri dhe llogaritet për komunën me biznes të fuqishëm dhe të qëndrueshëm të përkrahur me shërbime efektive shtetërore dhe publike për zhvillim.

Cilësia e jetës është përmirësuar përmes qasjes më të mirë drejt shërbimeve të përmirësuar, informacioneve dhe institucioneve për të gjithë qytetarët.

Deri në vitin 2011, arsimi në Strugë do të u përshtatet nevojave të ndryshme të bashkësisë komunale në procesin e modernizimit dhe zhvillimit.

Struga është njëra nga tri komunat e zgjedhura për të marrë pjesë në pilot programin e UNDP "Qeverisje lokale për zhvillim të qëndrueshëm njerëzor dhe ekonomik". I përkrahur financiarisht dhe teknikisht nga qeveria e Finlandës.

Fokusimi i projektit të UNDP "Qeverisje lokale për zhvillim të qëndrueshëm njerëzor dhe ekonomik", është përforcimin e kapaciteteve të vetëqeverisjes lokale, për sigurim efikas të shërbimeve dhe të planifikimit zhvillimor duke ofruar ambient të volitshëm për shërim ekonomik dhe mundësi komunikimi ndërmjet personelit të komunës dhe agjencive tjera publike dhe publikut më të gjerë. Strategjia gjithashtu promovon pjesëmarrje të shoqërisë qytetare në procesin e miratimit të vendimeve në komunë si garantë për transparencë dhe përgjegjësi të qeverisjes. Si pjesë të programit janë vënë kontakte të rëndësishme me tri komuna partnere nga Finlanda në partneritet me qeveri lokale, shoqëri qytetare, sektorin privat dhe gjithashtu me Agjenci të reja për zhvillim lokal, të themeluara me ndihmën e UNDP. Qëllimi kryesor është përkrahje të zhvillimit të Republikës së Maqedonisë përmes përfundimit të menaxhimit efektiv dhe inkluziv dhe përmirësimit të jetesës.

Rëndësia e zhvillimit të qëndrueshëm lokal për bashkësinë ndërkombëtare reflektohet përmes dokumenteve të ndryshme ndërkombëtare për zhvillim. Agjenda 21, udhëheqëse për zhvillim të qëndrueshëm, miratuar nga Konferenca për ambient jetësor dhe zhvillim të OKB-ës në Rio De Zheneiro në vitin 1992, e deklaroi rolin e pushteteve lokale dhe iniciativave në përkrahje të zhvillimit të qëndrueshëm. Roli i sektorit privat në ndërtimin e kapaciteteve, transferit të teknologjive dhe sigurimit të financave për zhvillim lokal u theksuan në Samitin Botëror për zhvillim të qëndrueshëm në Johannesburg në vitin 2002.

Sot llogaritet se partneritetet ndërmjet qeverive, shoqërive qytetare dhe sektorit privat janë të rëndësishme qësore për zhvillim të qëndrueshëm lokal.

Gjithashtu, Qëllimet Zhvillimore të Mileniumit parashin partneritet global, i cili është zhvilluar nga obligimet dhe qëllimet e vendosura në samitet botërore të viteve 1990. Si përgjigje ndaj sfidave kryesore zhvillimore dhe nevojave të shoqërisë qytetare, QZHM promovojnë zvoqim të varfërisë, arsimim, shëndet amnor, kualitet gjinor dhe përqëndrohen drejt luftës kundër vdekshmërisë së

fëmijëve, HIV-it dhe sëmundjeve tjera. QZHM janë përmblodhje e qëllimeve të vëna për vitin 2015, të cilat mund të arrihen nëse të gjithë pjesëmarrësit punojnë bashkërisht dhe e kryejnë pjesën e vet të detyrës.

Qeveria e ka nënshkruar deklaratën e Mileniumit në vitin 2000 me çka Maqedonisë i jepet mundësi të gjejë rrugë drejt zhvillimit afatgjat, sepse ka premtuar se do t'i arrijë QZHM.

Kjo SZHQL është shembull i veprimtarisë së UNDP-së për përfundimin e partneritetit ndërmjet komunave dhe promovimin e proceseve pjesëmarrëse për elaborimin e QZHM, strategji të shfaqura për zhvillimin lokal.

Ky dokument përfshin tri komponenta strategjike (të ashtuquajtura Strategji), të cilat janë të lidhura dhe të harmonizuara njëra me tjetrën:

- a. Vlerësimi i gjendjes lokale
- b. (SWOT) analiza- në katër tema: Infrastruktura, Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm, Kualitet të jetës dhe Arsimim dhe Përgatitje.
- c. Planet Strategjike- inkuadrojnë Vizioni, Qëllime strategjike, Qëllime zhvillimore dhe pasqyrë e shkurtër e Programeve dhe Projekteve.
- d. Plani aksional

Procesi zhvillimor i Strategjisë identifikonte lëmi prioritare dhe zgjedhje strategjike dhe vendos bazë të gjerë për zhvillim ekonomik, shoqëror dhe zhvillim kulturor të komunës së Strugës për periodën e viteve 2006 deri 2011. Ashtu sic leviz Maqedonia drejt integritimit në UE, përmirësimi i kapaciteteve të qeverive lokale duhet të shfrytëzohet për integrimin dhe harmonizimin e kesaj strategjie me politika evropiane, nacionale dhe regionale, të cilat shfaqen.

Përgatitja e strategjisë filloi në korrik të vitit 2005. Realizimi i saj u arrit në maj të vitit 2007 me përpjekjet e pushtetit lokal, i cili vepronte përmes Grupeve punuese, të cilët përfshinin përfaqësues të pushtetit lokal dhe të sektorit qytetar dhe privat dhe të cilët ishin të koordinuar nga Agjencioni për zhvillim lokal-Komuna e Strugës.

Procesin e udhëhoqën dy konsulentë lokal dhe një konsulent ndërkombëtar.

Zhvillimi i Strategjisë kaloi përmes 5 fazave:

Procesi i formulimit të strategjis

Faza e parë: Formimi i grupeve sipas lëmive tematike dhe mbledhjet e para me anëtarët e grupeve;

Faza e dytë: Tubimi dhe analiza e të dhënave mbi resurset natyrore, infrastrukturës, ekonomisë, sistemit për mbrojtje sociale dhe aspektet kulturore.

Faza e tretë: (SWOT) analiza (analizë e Prioriteteve, Mangësive, Mundësive, Kërcnimeve) për secilin grup veçanërisht.

Faza e katërt: Definimi i strategjisë të secilës lëmi tematike (vizioni, qëllimet strategjike, qëllimet zhvillimore, programet dhe projektet);

Faza e pestë: Integrimi i pjesëve të SWOT analizës dhe strategjitë në katër lëmi prioritare ose tema:Infrastruktura, Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, Kualitet të jetës Arsimim dhe përgatitje.

Përpunimi i Strategjisë u arrit përmes një procesi të gjerë të konsultimeve. Përfaqësuesit e grupeve punuese dhe shërbyese, bashkësia dhe sektori volunter dhe administrata komunale morën pjesë dhe kontribuan drejt strategjisë pas miratimit politik të procesit nga prefekti dhe Këshilli i Komunës.

U formuan katër grupe punuese që punuan në këto përmbledhje tematike:

- i Sipërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme
- ii Turizmi dhe hoteleria
- iii Zhvillimi rural dhe bujqësia
- iv Planifikimi urban, problemet komunale dhe ekologjia
- v Arsimi
- vi Kultura, sporti dhe rinia
- vii Shëndetësia, mbrojtja sociale, mbrojtja civile dhe mbrojtja zjarrfikëse

Grupet punuese organizuan orarin e vet, të përkrahur nga Zyra për Zhvillim Ekonomik Lokal (ZZHEL).

Verzioni i parë i strategjisë u koordinua nga Zyra për Zhvillim Ekonomik Lokal (ZZHEL). dhe u shqyrty nga ekipi konsulent dhe verzioni i parë që përgatitur për konsultime dhe vëzhgime të mëtutjeshme nga ana e qytetarëve përmes përfaqësuesve të tyre.Verzioni përfundimtar u prezantua dhe u miratua para Këshillit të Komunës.

1 Profili i komunës së Strugës



1.1. Te dhëna te përgjithshme

1.1.1 Pozita Gjeografike

Në pjesën jugperëndimore të Republikës së Maqedonisë shtrihet Pellgu i Ohrit dhe Strugës, i vendosur ndërmjet maleve Jabllanica, Malit të Belicës dhe Mokrës në perëndim, Galiçicës, Petrines, Malit Pllaçin dhe Ilien në lindje, Stogovës dhe pjesës së saj e Karaormanit në veri dhe krahinës malore Gora në jug.

Pellgu perfshin sipërfaqe prej 103.407ha.

Struga gjendet në lartësi mbidetare prej 698m.

Struga është e vendosur në rrëzë të malit Jabllanica në Pellgun e Ohrit dhe në anën veriore të Liqenit të Ohrit pranë vendit ku rrjedh lumi Drini i Zi po nga Liqeni i Ohrit. Mendohet se qysh nga periudhat e hershme kohore ka egzistuar një vendbanim me emrin Enhalon, emër që mendohet se ka prejardhje nga gjuha e vjetër greke, që në përkthim do të thotë ngjalë. Më vonë vendbanimi e mori emrin Strugë, që don të thotë mëngë dore, hu edhe atë në vendin e gjuajtjes së peshkut.

Komuna e Strugës përfshin sipërfaqe prej 573ha, ose në 1/3-tën pjesë nga linja e përgjithshme bregore e liqenit, d.m.th në gjysmën e sipërfaqes së përgjithshme të pellgut. Në këtë sipërfaqe ndodhet qyteti Strugë me 50 vendbanime (Misleshova, Draslajca, Moroishta, Llozhani, Bixhova, Vranishta, Belica e Poshtme, Zagraçani, Kalishti, Mali Vllaj, Ladorishti, Radozhda, Frëngova, Shumi, Oktisi, Vishnja, Belica e Epërme, Drenoku, Modriçi, Gilloboçica, , Nerezi, Bezeva, Jabllanica, Llakajca, Priskupshtina, Burineci, Zbzhzdi, Llukova, Prisojvani, Rzhanova, Sellca, Brezova, Bogovica, Toska, Dollogozhda, Koroshishta, Livadhia, Mislodezhda, Novosela, Pohumi, Zhepini, Boroveci, Llabunishti, Podgorca, Tashmaronishta, Veleshta, Tateshi i Epërm, Tateshi i Poshtëm dhe Dobovjani).

Fshatrat shtrihen :

- Nga ana e majtë e Drinit në lindje të rrëzës së Malit Jabllanica, si fshatra të Drimkollit të Strugës dhe dy fshatra ne bregun e liqenit.
- Në rrëzën malore të Jabllanicës fshatrat e Drimkollit të Dibrës.
- Nga ana e djathtë e Drinit ndodhet krahina e Ma-

lesise, por më në veri të saj krahina e Zhupës së Dibrës.

- Në rrëzen jugore të Karaormanit dhe në skajin e fushës.
- Në pjesën përfundimtare të Fushës së Strugës.

Fshatrat e Komunës së Strugës kryesisht janë të tipit të ngushtuar.

1.1.2. Klima

Sa i përket klimës, gjegjësisht teperaturës, sipas pozitës gjeografike të Strugës, mund të thuhet lirisht se në Strugë sundon klimë subtropike, por ndikim ushtrojnë edhe rrymat e saja ajrore dhe klima kontinentale.

Duke qenë e rrethuar me kodrina malore, sepse në përfundim ndodhet Jabllanica, në veri-lindje Karaormani, në jug-lindje Galiçica, si dhe hapësira e Fushës së Strugës në rrjedhën e lumit Drini i Zi dhe Sateska nga veriu, të gjitha këto kanë kushtëzuar temperatura më të ulëta dimërore.

Temperatura maksimale e ajrit në muajt korrik dhe gusht mund të sillet nga 28 C- 33 C. Në sezonën verore gjegjësisht në muajt korrik dhe gusht temperatura e ujit mund të arrijë deri në 26, 4 C,

Numri mesatar i ditëve me temperaturë verore të ajrit (më e larta është 25 gradë dhe e pjesës siperfaqësore të ujit të liqenit arrin 20 gradë) arrin në 73 -78 ditë, me intensitet më të madh në korrik dhe gusht.

Në periudhën dimërore të vitit temperaturat mesatare mujore arrijnë mbi zero.

Në viset malore mbi 1600 m.l.mb. temperaturat më të ulëta dhe nën zero fillojnë nga muaji dhjetor dhe zgjasin deri ne fundin e muajit mars.

Insolacioni

Insolacioni në Strugë dhe në regjionin përkatës është mjaft i lartë. Me 2208.3 orë vjetore, Struga e zë vendin e parë në Republikën e Maqedonisë. Në periudha të ndryshme vjetore Sruga ka shkëlqim të ndryshëm diellor. Kështu p.sh nga muaji dhjetor deri në muajin gusht shkëlqimi diellor është më i gjatë, kurse e kundërta është nga muaji gusht deri në muajin nëntor. Në muajt korrik dhe gusht



insolacioni mesatar arrin nga 10-12 orë, me çka vërehet ndikim pozitiv në klimën e përgjithëshme të qytetit të Strugës.

Vransirat

Të dhënat statistikore tregojnë se në Strugë dhe në Pellgun e Strugës vranësirat janë më të mëdha në muajin dhjetor dhe arrijnë deri në 7.2 orë në ditë, ndërsa më të vogla janë në gusht kur zbesin deri në 1.4 orë.

Te reshurat

Të reshurat e shiut në Pellgun e Strugës janë të ndryshueshme. Të reshurat mesatare të shiut sillen rreth 600-700 mm, kurse në malet përreth arrin prej 2000-2500 mm shi dhe si shembull mund të merret mali Jabllanica.

Në pellgun e Strugës ka 96 ditë me reshje gjatë vitit dhe reshje deri në minimum në muajt e verës.

Erërat

Pozita gjeografike e Strugës, hapja e Pellgut të Strugës, malet përreth qytetit si dhe afërsia e liqenit, mundësojnë që në Strugë të fryjnë erëra nga të gjitha anët.

Erërat ndahen në të përhershme dhe lokale.

Në erërat e përhershme përfshihen erërat që vijnë nga jugu dhe nga veriu.

Erërat e veriut zakonisht vijnë nga lugina e lumit Drini i Zi dhe bartin freski, fryjnë pothuajse gjatë gjithë periudhës vjetore, por më shumë në dimër.

Erërat jugore fryjnë zakonisht në mars dhe prill dhe më rrallë në maj.

Era e jugut është e përshtatshme për gjueti të ngjaleve, trembelak dhe grunca.

Erërat lokale janë prodhim i ngrohjes jo të njëjtë të sipërfaqes dhe masës së ujit të liqenit.

Erë karakteristike e Liqenit të Ohrit është era Stermec (Rrëpirë).

Vjen nga malet përfaqar dhe prandaj është e ftohtë, fryn gjatë tërë natës deri në agim me frymë të qetë dhe valë të plota.

1.1.3 Resurset natyrore

Hidrografia

Në territorin e Luginës së Strugës dhe Ohrit ndeshen më shumë lloje të ujërave. Disa janë ujëra nëntokësore, burime dhe përroje, ndërsa ujërat tjerë rrjedhës, kurse të tretët janë ujëra natyrorë (tektonikë dhe nga akullnajet) dhe liqene artificiale.

Liqeni i Ohrit gjendet në Pellgun e Ohrit ndërmjet Galiçicës gëlqerore në lindje dhe mes maleve Jabllanica dhe Mokra në perëndim. Niveli i sotëm i liqenit ndodhet në 695 metra lartësi mbidetare, gjejgjisht më e ulët nga e mëparshmeja për 265 metra. Liqeni ka formë të përzgatur. Shtrirja e gjatësisë është në drejtim veri-jug, nga Struga deri në Shën Naum. Rreth 40% nga sipërfaqja e thellësisë së liqenit është nën dyqind metra thellësi.

Liqeni furnizoet me ujë nga kanalet nëntokësore përmes Galiçicës nga ujërat e Liqenit të Prespës. Burimet më të shumta dhe më të pasura me ujë (rreth tetëdhjetë burime) ndodhen ndërmjet Shën Naumit, Maqedonisë dhe Tshemishtit, Republika e Shqipërisë, në gjatësi prej pesë kilometrash.

Në bazenin e Liqenit të Ohrit ka rreth pesëdhjetë miliardë m³ ujë, kurse liqeni ka sipërfaqe prej 348 km². Lumi Drini i Zi është e vetmja derdhje nga Liqeni. Drini i Zi është rregullator i nivelit të ujit në liqe. Në rrjedhën e Liqenit të Ohrit ka dy liqene artificiale Gllaboçica dhe Liqeni i Dibrës.

Nga resurset tjera hidrografike rëndësi më të madhe kanë: Drini i Zi, Sateska, Liqeni i Gllaboçicës, Liqenet Glaciale në malin Jabllanica, Liqenet e Belicës së Sipërme dhe burimet e Vevçanit si dhe rrjedha e ngrohtë në Shum.

Mineralet dhe xehet

Në bazenin Strugan ekzistojnë hapësira të fosileve të qymyrgurit, edhe atë në afërsi të fshatit Priskupshtinë, që shfrytëzohet në mënyrë sipërfaqësore.

Nga llojet tjera të mineraleve janë të njohura llojet karakteristike të gurit që përdoren në ndërtimtari për pllaka dhe shfrytëzohen kryesisht në rrethinën e Vevçanit.

Bota bimore

Rrjedha e lumit Drini i Zi me grykën e saj të thellë, shtresën gjeologjike, konfiguracionin e terrenit, vendndodhjen dhe karakteristikat e veçanta klimatike mundësojnë zhvillim të numrit më të madh të llojeve të bimëve të cilat jetojnë vetëm në këtë regjion.

Në Fushën e Strugës është zhvilluar vegjetacioni kënetor, kurse në bregun e liqenit është prezent kallmi (kallami).

Në skajin nënmalor të Jabllanicës është e zhvilluar vreshtaria për verë dhe pas saj fillon pylli me gështenja të buta. Mbi pllajat me gështenja rritet pylli me dru dushku, kurse mbi to pylli me dru ahu.

Në viset malore mund të gjenden një numër i madh i barërave shërues, bimë dekorative dhe numër i konsiderueshëm këpurdhash.

Bota shtazore

Disa lloje shtazësh e kanë prejardhjen nga e kaluara e largët gjeologjike dhe janë begati e vërtetë për shkencën biologjike maqedonase.

Më shumë lloje sisorësh me perjashtim të të vegjëlve, lirisht mund të trajtohen si të rrezikuar me shkallë rrezikshmërie për shfarosje të disa llojeve të veçanta.

Në malet përreth jetojnë disa lloje të kafshëve të egra të mëdha edhe atë: ariu, ujku, rrëqebulli, kaprollja, macja e egër, dhia e egër, derri i egër.

Përfaqësues karakteristik të regjionit të Strugës në pjesën moçalike dhe bregore janë edhe shpezët e moçalit:

çapiu, shpezët notues, kojrrile, lejlek i zi, patë e egër dhe patë e egër e vogël.

Bota bimore dhe shtazore në ujërat e Liqenit të Ohrit

Bota bimore dhe shtazore në Liqenin e Ohrit pothuaj se nuk ka ndryshuar që nga formimi deri sot. Fjala është për fenomenin –endemizëm që shënon lloje të cilët ekzistojnë vetëm në një lokalitet të caktuar dhe në asnjë vend tjetër.

Në liqec ekzistojnë rreth 146 lloje organizmash. Në mesin e këtyre llojeve ekziston njëri nga llojet endemorelikte nga më karakteristikët- shfungjeri.

Në liqec ka gjithsej shtatembedhjetë lloje peshqish që u takojnë tri grupeve: të troftave, peshq të bardhë dhe ngjala.

Grupit të ujëtokësorëve u takojnë bretkocat, kurse grupit të zvarranikëve disa lloje të gjarpinjëve të ujit.

Sipas të dhënave të deritanishme flora në Liqenin e Ohrit është e perfaqësuar nga më shumë se 750 lloje bimësh si alga, likene, këpurdha dhe zambak të ujit.


1.1.4 Popullata dhe migrimet

Sipas shënimeve të regjistrimit të popullatës zhvilluar në vitin 2002 në Komunën Strugës kishte 63.376 banorë. Ky numër nuk ka ndryshuar esencialisht në krahasim me numrin e banorëve me regjistrimin e vitit 1994 (sipas Organizatës së atëhershme Administrative-Territoriale), kur në komunën e atëhershme jetonin 62.679 banorë.

Në qytetin Strugës jetojnë 16.550 banorë

Shkalla e nataliteit në vitin 2004 ishte 10,2% (në 1000 banorë), kurse shkalla e mortalitetit të përgjithshëm ishte 7,5% (në 1000 banorë). Shkalla e vdekshmërisë tek foshnjat ishte 10,6 promila. Shumëzimi natyror në numra ka qenë 101, në promila 2,7. Me këto të dhëna komuna është nën mesataren e Republikës.

Qarku i migracionit në vitin 2004 është 6. Ndaj saj si



të ardhur janë regjistruar gjithsej 223 persona, nga të cilët 152 janë qytetarë të ardhur brenda Republikës së Maqedonisë. Numri i përgjithshëm i të shpërngulurve është 217, prej të cilëve 150 janë qytetarë të shpërngulur brenda R.së Maqedonisë.

Karakteristikë është se nga numri i përgjithshëm i qytetaëve të shpërngulur (113) janë të gjinisë femërore, kurse shkaqet më të shpeshta për shpërngulje janë kurorëzimi dhe shkaqet tjera familjare (respektivisht 78 dhe 52).

Numri mesatar i banorëve është 130, 5 persona na km².

Numri i kurorëzimeve në vitin 2004 ishte 288 ose 7, 8 kurorëzime në 1000 banorë dhe numri i shkuroëzimeve ishte 12 ose 0.3 shkuroëzime në 1000 banorë. Në raport me kurorëzimet komuna është mbi mesataren, ndërsa në krahasim me shkuroëzimet komuna është nën mesataren Republikane, gjegjësisht i takon grupit të komunave me shkallë më të ulët të shkuroëzimeve.


Struktura sipas gjinisë në Komunën e Strugës është 31.743 (50%) të gjinisë femërore dhe 31.633 (50%) të gjinisë mashkullore.

Shkalla mesatare e moshës së populates sipas regjistrimit të vitit 2002, është 33, 1 vite.

Pjesëmarrja e popullatës së re deri në moshën 20 vjeç është 36, 2%. Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të banorëve ka popullata me moshë nën dyzet vjeç 67, 2%, ndërsa përqindja e banorëve mbi 60 vjeç është 11, 7.

Struktura e popullatës mbi bazën e perkatësisë nacionale në Komunën e Strugës

Nacionaliteti	Numri i banorëve	%
Maqedonas	20336	32
Shqipetarë	36029	56.5
Turq	3628	6
Romë	116	0.18
Vllehtë	656	1
Serbë	106	0.16
Boshnjakë	103	0.16
Të mbetur	2402	4
Gjithsej	63376	100



1.1.5. Ambienti Jetesor

Komuna e Strugës gjendet pranë njërit prej liqejeve më të pastër dhe shumë të pasur me forma endemike të jetës, me lumenj shumë të bukur, me male e me pyje me florë dhe faunë specifike.

Në vitin 2002 është sjellur dhe miratuar LEAP dokumenti për Komunën e Strugës.

Nga aspekti ekologjik për komunën dhe rrethinën e saj më të afërt vlejné po të njëjtat veçori dhe vështirime, të cilat vlejné për ndotjen ekologjike globale.

Karakteristikë e regjionit të Strugës është shfrytëzimi pa plan i pyjeve, shfrytëzimi i drurit dhe qymyrit për përfitimin e energjisë së ngrohjes, mospërcaktimi dhe mungesa e një deponie komunale për mbeturina të forta, sistemi i papërfunduar i kolektorit, problemi i rregullimit të rrjedhës së lumit Sateska, mungesa e mbrojtjes adekuate rreth bregut të liqenit dhe të kallmit, kontrollimi i dobët dhe nuk ka parandalim as sanksione kundër vjedhësve të peshkut dhe gjuetarëve vjedhës etj.

Momentalisht në sferën e mbrojtjes së ambientit aktivisht funksionojné rreth dymbëdhjetë organizata joqeveritare në pjesën urbane dhe rurale të komunës. Ato punojné në disa lëmi edhe atë:

- në lëminë e **llojshmërisë biologjike**. Aktivitetet shtrihen në promovim, mbrojtje, mirëmbajtje e shrytëzim të ekosistemeve të ujërave dhe të bregut të liqenit, të ekosistemeve pyjore si dhe të ekosistemeve malore
- në lëminë e **ndryshimeve klimatike** aktivitetet shtrihen drejt efikasitetit në energjetikë dhe promovimin dhe shfrytëzimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë
- në lëminë e **ujërave ndërnacionale** aktivitetet shtrihen në drejtim të theksimit ekologjik të sipërfaqeve të ujërave ndërmjet qyteteve, në rrezikshmërinë nga ndotja sipërfaqësore dhe nëntokësore, që e percaktojnë dhe kushtëzojnë kualitetin e ujërave.
- në drejtimin e **degradimit të tokës** aktivitetet shtrihen në drejtim të udhëheqjes së integruar me sipërfaqet ujore, mbrojtje të tokës, pyllëzim, mbrojtje nga zjarret pyjore dhe ngajshëm.

Menaxhimi me mbeturinat

Mbeturinat e Komunës së Strugës në mënyrë të organizuar barten nga shërbimet e Sipërmarrjes Publike "Komunallno". Në kuadër të sipërmarrjes funksionon edhe shërbimi për kultivimin e luleve, që ndodhet në pjesën perëndimore të qytetit dhe që ka një sipërfaqe prej 60m². Në vendbanimet fshatare hedhurinat hidhen ku të mundet dhe për këtë shkak formohen deponi të egra.

Komuna e Strugës nuk ka deponi të përhershme ku do të mund të deponohen mbeturinat. Ekziston vetëm një deponi e përkohëshme, që gjendet shumë afër qytetit.

Deponia e përkohëshme nuk i plotëson standardet elementare sanitare sipas rregullave. Deponia nuk ka infrastrukturë të njevojshme (ujë, rrymë elektrike) dhe nuk

ka mjete për dezinfektim si dhe gropë për kafshët e ngor dhura.


Mbeturinat industriale dhe medicinale gjithashtu hidhen në deponinë e përkohshme. Mbeturinat nuk kanë asnjë trajtim teknik, por ato vetëm hidhen, nivelizohen dhe mbulohen me dhe dhe rërë.

1.2. Ekonomia

Sipas statistikave lokale Komuna e Strugës në vitin 1995 merrte pjesë në prodhimtarinë shoqërore të republikës me 1, 4%, përderisa për një banor realizonte 43, 5% nga mesatarja e Republikës. Do të thotë se në fillim të viteve nëntëdhjeta të shekullit të kaluar (faza fillestare e tranzicionit) struktura e ekonomisë ishte me sa vijon: industria dhe xehetaria 46%, bujqësia dhe peshkataria me 18%, ndërtimtaria me 2, 7%, tregëtia me 14, 8%, hoteleria dhe turizmi me 7, 1%, mjeshtritë dhe shërbimet personale me 2, 2%, shërbimet banesore dhe komunale me 4, 4%, shëndëtiesia dhe mbrojtja sociale me 1, 5% dhe të gjitha të tjerat me 3, 3%.

Sot, në mungesë të statistikave ekonomike lokale, mund të bëhen përlllogaritje përgjithësuese vetëm mbi bazën e krahasimeve mbi të dhënat ekonomike themelore sa i përket ekonomisë nacionale dhe regjionit të cilit i takon komuna. Kështu, shkalla mesatare e rritjes të (VDR) për periudhën 1998-2002 në shakallë republike arrin vetëm 5, 2%, kurse për regjionin në të cilin shtrihet komuna (Regjioni Jugperëndimor) shkalla e rritjes është vetëm 2, 8%. Gjithashtu për regjionin, (VDR) për banor sillet rreth 41, 92 \$ amerikan dhe si i tillë është më i ulët se mesatarja e vendit për 39% dhe çka është posaçërisht e rëndësishme se shkalla mesatare vjetore e vlerës së shtuar nga sektori jo financiar në periodën 1998-2002 është negative dhe përfshin -1, 1% në krahasim me mesataren e republikës prej 3%.

Analiza më ekzakte për ekonominë lokale mund të sajohen mbi bazën e të dhënave për numrin e subjekteve afariste sipas llojit dhe sektorët e veprimtarisë dhe sipas të dhënave të punësimit në komunë.



1.2.1. Numri dhe struktura e subjekteve afariste

Struktura ekonomike e Komunës së Strugës sipas sektorëve të veprimtarisë është e pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

SUBJEKTET AFARISTE SIPAS SEKTOREVE TE VEPRIMTARISE	Ne %	
BUJQESIA, GJUTIA DHE PYJTARIA	86	2.60
NXJERRJA MINERALE DHE GUR	6	0.18
INDUSTRIA PERPUNUESE	347	10.50
FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE, GAZ DHE UJE	3	0.09
NDERTIMTARIA	376	11
TREGETIA ME SHUMICE DHE PAKICE, NDERQJA E MAKINAVE DHE MJETEVE PER NEVOJA PERSONALE DHE AMVISERI	1563	48
PESHKIMI	10	0.30
HOTELET DHE RESTORANTET	251	7.60
KOMUNIKACIONI, TRANSPORTI DHE LIDHJET	202	6.11
NDIHMAT FINANCIARE	5	0.15
AKTIVITET NE LIDHJE ME PASURINE E PATUNDSHME, NDERMARRJE E AKTIVITETEVE AFARISTE	115	3.48
QEVERISJA PUBLIKE DHE MBROJTJA E DETYRUESHME	29	0.87
ARSIMI	15	0.45
SHENDETESIA DHE PUNA SOCIALE	54	1.63
TE TJERA AKTIVITETE KOMUNALE, KULTURORE, TE PERGJITHSHME DHE AKTIVITETE PERSONALE	241	7.40
GJITHSEJ	3303	100

Sipas tabelës mund të vijnë në perfundim se nga numri i kompanive veprimtari dominuese është tregtia (me pjesëmarrje deri në 48%), pastaj vijnë ndërtimtaria me (11%), industria përpunuese me përafërsisht (11%), turizmi dhe hoteleria me përafërsisht 8%, aktivitetet tjera komunale, kulturore, shërbimet e përgjithshme dhe personale me rreth 7% dhe të gjitha të tjerat me rreth 15%.

1.2.2. Fuqia puntore, Punësimi dhe Papunësia

Fuqia punëtore (banorët aktivë ekonomikë që perbëjnë të punësuarit dhe të papunët) në komunë sillet rreth 30%. Shkalla e papunësisë arrin deri në 30.4%, kurse e të punësuarve është 41.5%. Shkalla e papunësisë sipas numrit të regjistruar të të papunëve sillet rreth 41.1%, ndërsa ajo faktike është 30.4%, ndërsa shkalla e të punësuarve arrin në 23.9%.

Parqyrë e personave të punësuar në Komunën e Strugës

Gjithsej		prej 15-19 vjeç		prej 20-24 vjeç		prej 25-29 vjeç		prej 30-34 vjeç		prej 35-39 vjeç		prej 40-44 vjeç		prej 45-49 vjeç		prej 50-54 vjeç		prej 55-59 vjeç		mbi 60 vite	
Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra
9283	3592	353	177	1334	567	1295	556	1317	505	1187	462	1164	470	1013	374	805	286	568	168	247	27

Pasqyre e personave te papune sipas kualifikimit

Komuna	Gjithsej		Te pakualifikuar		Gjysem i kualifikuar		I kualifikuar		Kualifikim i lart		Shkollim i mesem profesional		Me shkolle te lart		Me fakultet		Magjistra		Doktore	
Strugë	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra
	9283	3592	4802	2062	1051	242	1221	300	0	0	1742	768	148	59	315	161	3	0	1	0

Pasqyre e personave te papunesuar sipas perkatesise nacionale

Komuna	Gjithsej		Maqedonas		Shqiptarë		Turq		Romë		Serbë		Vllehe		Te tjere	
Strugë	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra
	9283	3592	4301	1810	3747	1413	148	65	101	39	10	3	16	6	960	256

Pasqyre e personave te papunesuar sipas kohëzgjatjes të pritjes për punësim

Komuna	Gjithsej		Nen 1m.		prej1 deri 5		Prej6 deri 11		prej 12 deri 17		prej18 deri 23		2 vite		3 vite		4 vite		5 deri 7 vite		8 vite e me teper	
	Strugë	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane	Femra	Jane
	9396	3613	228	78	820	302	861	334	807	320	591	225	1069	447	973	436	896	415	1256	460	1895	596

Numri i personave të papunësuar në Komunën e Strugës

Komuna	Numri i të papunësuarve	Vendbanimi	
		Qytet	Fshat
Strugë	9283	3170	6113

Nga të dhënat e mësipërme tabelare mbi strukturën e të papunësuarve mund të nxirren këto konstatime vijuese:

Sipas përkatësisë gjinore nga numri i përgjithshëm i personave të papunësuar në Komunën e Strugës (9283); femra janë 3592 (52%) kurse meshkuj janë 5691 (61%).

Sipas moshës kufitare, më tepër të papunësuar janë të moshës nga 20-24 vite - 1334 (14.37%), pastaj vijnë ata nga 30-34 vite - 1317 (14.19%) dhe ata ndërmjet 25-29 vite - 1295 (13.95%).

-Sipas kualifikimit, numri më i madh i të papunësuarve janë fuqi punëtore me kualifikime të ulëta 4802 (52%), vijojnë ata me arsimim të mesëm 1742 persona (19%), dhe fuqi punëtore e kualifikuar me 1221 persona (13%).

-Sipas përkatësisë nacionale, numri më i madh janë maqedonë -4301 persona (47%), pastaj vijnë shqiptarët me 3747 persona (40%) dhe të tjerë 13%.

-Sipas kohëzgjatjes së pritjes, numri më i madh i të papunësuarve që presin për punësim për disa vite është: 20% (1895), i personave që presin për punësim më shumë se tetë vite, 14% (1256), persona që presin nga 5-7 vite, 12% (1069) persona që presin 2 vite.

-Sipas vendbanimit, 34% ose 3170 persona të papunësuar jetojnë në qytet, kurse 66% ose 6113 persona janë nga fshatrat.

-Papunësimi i banorëve të moshës rinore (si përqindje e fuqisë punëtore të moshës nga 15 deri 24 vite) është 69.1% dhe me të komuna është nën mesataren republikane si dhe nën mesataren e tërë regjionit (respektivisht 72.5% dhe 75.4%).

-Numri më i madh i personave të punësuar janë në sektorin shërbyes, pastaj ata në industri, bujqësi dhe në sektorë të tjerë.

-Në Komunën e Strugës ka 6066 pensionistë.

1.2.3. Përshkrim i sektorëve ekonomikë

Industria e tekstilit

Struga tradicionalisht është e njohur si prodhuese e perdeve dhe trikotazhit. Kjo degë ekonomike në të kaluarën mundësonte punësimin e më shumë banorëve të komunës (rreth 3000 persona). Në periudhën e tranzicionit pjesa më e madhe e kapaciteteve më të mëdha nuk arriti që në mënyrë adekuate t'u përshtatet kushteve të reja të ekonomizimit dhe një pjesë e tyre u privatizuan, kurse disa ende janë në fazë të privatizimit dhe të ristartimit.

Në ndërkohë u paraqitën shumë firma të vogla të tekstilit, të cilat kryesisht merreshin me prodhimin konfeksional, të dedikuara për blerës të njohur. Dhe një pjesë tjetër e tyre u ngritën deri në liderë të industrisë së re tekstile në Strugë.

Në një afat të shkurtër kjo industri pati ndikim pozitiv në zvoglimin e tensioneve sociale, sepse arrin të punësojë numër më të madh njerëzish (rreth 1000).

Shikuar në afat më të gjatë kohor industria tekstile ka tendenca të rënies dhe nuk ka perspektivë.

Industria e drurit

Për shfrytëzimin ekonomik të pyjeve në Komunën e Strugës përgjegjëse është Sipermarrrja Publike Pyjet e Maqedonise, filialë e së cilës është Jabnllanica. Rreth 90% e pyjeve aktualisht janë në pronësi të shtetit.

Nga fundi i viteve nëntëdhjetë, si njëri prej kapaciteteve më të mëdha të komunës ishte kombinati i drurit, i cili përveç veprimtarisë së vet kryesore zhvillonte edhe veprimtari sekondare (parketim, prodhim të drurit për ndërtime dhe përpunim të drurit).

Zhvillimi i industrisë së drurit është duke ecur drejt ngritjes që nga viti 1990 e këndej. Disa firma lokale kanë reparte më të mëdha për prodhimin e mobiljeve me orientim për eksport.

Në komunë ekzistojnë një numër më i madh mini-ndërmarrje të drurit, që prodhojnë material druri për ndërtimtarë.

Industria ndërtimore

Tradicionalisht rrethina e Strugës është e njohur me ndërtimtarët e saj shumë të vyeshëm e të palodhshëm, të cilët kanë punuar pothuaj në të gjithë Gadishullin Ballkanik dhe nëpër botë.

Tradita e tillë në periudhën ndërmjet viteve 1945-1990 ishte e organizuar përmes disa firmave të mëdha, të cilat merreshin me ndërtimin e infrastrukturës dhe të kapaciteteve të mëdha industriale.

Në periudhën e tranzicionit këto firma të mëdha u privatizuan dhe u shfaqën shumë mini-firma të ndërtimtarisë me specializim të cinguar dhe park ndërtimor modern. Pronarët e pjesës më të madhe të atyre firmave përvojën në këtë lëmi e kanë arritur duke punuar në firmat ndërtimore të jashtme. Njëkohësisht u paraqitën edhe firma të cilat filluan me prodhimin e materialeve bashkëkohore të ndërtimit si dhe të elementeve të gatshme të industrisë ndërtimore.

Shërbimet

Tregtia

Në qytet dhe fshatra funksionojnë një numër i madh marketesh, furnizimi i të cilave i plotëson kërkesat e konsumatorëve. Në sipërfaqen qendrore të qytetit ka një treg të gjelbërt të furnizuar shumë mirë, i cili sipas sipërfaqes së shtrirjes dhe pozitës funksionale nuk mund t'u shërbejë si duhet qytetarëve dhe turistëve.

Shërbimet e transportit

Në Komunën e Strugës transporti tokësor është i organizuar nga ana e më shumë transportuesve privatë. Nëpër fshatra komunikacioni zhvillohet përmes transpor-

tit në linja për udhetarë nga ana e autotransportuesve privatë të licencuar.

Shërbimet transportuese ajrore zhvillohen përmes aeroportit të Ohrit, i cili gjendet 7 km më larg nga qyteti. Ekzistojnë fluturime të rregullta si dhe çarter fluturime në të gjitha destinacionet më të rëndësishme botërore dhe europiane.

Dymbëdhjetë km. në jug-perëndim gjendet vendkalimi kufitar Qafa e Thanës drejt Republikës së Shqipërisë.

Në qytet gjendet Terminali Doganor ku mund të bëhen të gjitha zhdoganimet e importit dhe eksportit i të gjitha llojeve të mallit.

Ekzistojnë edhe tri shërbime shpeditoni

Shërbimet financiare dhe shërbimet e tjera

Në Strugë bankat më të mëdha të Republikës së Maqedonisë i kanë filialet e tyre. Bankat që i zhvillojnë shërbimet e tyre financiare në pjesën më të madhe janë me kapital të huaj.

Në pjesën e shërbimeve financiare, shërbimet e veta financiare dhe shërbimet e tyre të sigurimeve, mundësohet që shoqatat e sigurimeve të kenë filialet e veta në Strugë. Shoqatat e sigurimeve kryesisht funksionojnë me kapital të huaj.

Në komunë shërbimet e veta i ofrojnë një numër i madh i firmave të kontabilitetit.

Në nivel komunal funksionon Qendra Informatike, që mundëson përgatitje për teknologji informatike për administratën e komunës. Në komunë ka më shumë firma private që i ofrojnë shërbimet e tyre në sferën e IT teknologjisë, internetit dhe telekomunikacioneve.

Për qytetarët ofrohet qasje në zyrat e avokatëve privatë dhe të noterëve, si dhe një zyrë regjionale e zbatimit gjuqësor.

Shërbimet postare zhvillohen përmes Postës Qendrore në Strugë dhe pesë postave të ndara në fshatrat më të





mëdhenj.

Bujqësia

Në Komunën e Strugës aktualisht punohen rreth 7.000 hektarë tokë punuese bujqësore edhe atë:

- Me kultuorë drithërash rreth 4.000 hektarë; 1, 5t/ha dhe kashta shfrytëzohet pothuajse tërësisht.
- Me misër mbillen rreth 1.500 hektarë nga të cilët pjesa më e madhe me farëra hibride,
- 1.500 hektarë u takojnë kulturave tjera bujqësore
- Në Komunën e Strugës janë të regjistruara gjashtë sipërmarrje bujqësore.

Zyrtarisht 414 persona merren me bujqësi, blegtori, shpeztari dhe bletari, por numri i saktë është shumë më i madh.

Puna fushore dhe pemëtaria

Kultura kryesore fushore janë gruri dhe elbi. Sipas shënimeve të marra nga Ministria Rajonale e Bujqësisë në vitin 2005 prodhimitaria e këtyre kulturave ishte me sa vijon:

Kulturat kryesore bujqësore	Sipërmarrjet bujqësore	Prodhuesit individual
Misri	735 tonë	10860 tonë
Elbi	22 tonë	1500 tonë

Në regjionin e Strugës potencialet e pemëtarisë nuk janë të shfrytëzuara mjaftueshëm. Kultura më të shumta të pemëve janë mollët dhe kumbullat. Në vitin 2005 u arrit prodhimitari prej 195 tonë mollë nga sipërmarrjet bujqësore dhe 300 tonë mollë nga prodhuesit individualë.

Numri i përgjithshëm i sipërfaqeve të mbjella me këtë kulturë ishte 30 hektarë në sektorin shtetëror dhe 20 hektarë në sektorin privat.

Sasia e hektarëve të mbjellur me vreshta është 60 hektarë në sektorin shtetëror dhe 30 hektarë në sektorin privat.

Blegtoria

Në vitin 2005 në Komunën e Strugës janë regjistruar 5.536 lopë dhe 21.136 dele. Problem më i madh për blegtorinë është shitblerja e qumështit.

Ekzistojnë tri shoqata veterinarë private.

Në Komunën e Strugës ka gjithsej 7.933 hektarë kullota. Në sektorin privat ka 1.383 hektarë, kurse në atë komunal 6.550 hektarë. Prej tyre kullota që u takojnë viseve të larta malore janë 3.950 hektarë dhe 3.983 hektarë janë kullota që shtrihen në viset e ulta malore.

Pylltaria

Në territorin e Komunës së Strugës, fondi i pyjeve shtrihet në sipërfaqe relativisht të mëdha. Masa e përgjithshme e drurit në pyjet e komunës së Strugës llogaritet të jetë rreth 1.962.160 m³, me shtim të përgjithshëm vjetor rreth 38.947 m³. N.P. "Pyjet e Maqedonis", EPP "Jabllanica" zhvillojnë veprimtari afariste me sipërfaqe të përgjithshme prej 28.787 hektarësh, nga të cilat 21.511 hektarë ose rreth 90, 5% janë në pronësi shtetërore, ndërsa 2.276 hektarë ose 9, 5% janë pronë personale. Përsa i takon cilësisë,

rreth 30, 4% e pyjeve me të cilat zhvillon afarizëm EPP"Jabllanica"-Strugë janë rrënjë druri të lartë, kurse 69, 9% janë rrënjë të drurit të ultë.

Sipas përdorimit 100% e pyjeve janë të karakterit ekonomik. Prerja vjetore në EPP"Jabllanica" të Strugës në vitet e fundit sillet rreth 33.000-34.000 m³ në vit, nga të cilat:

- rreth 27.000 m³ në vit janë dru për djegie (20.000 m³ në vit dru ahu dhe 7000 m³ në vit dru dushku)
- 2.600-3.000 m³ në vit janë dru për qëllime teknike (trupa të kategorisë së parë, të dytë dhe të tretë)

Paraqitja e detajuar e sipërfaqeve pyjore dhe pyjeve me të cilat zhvillon ekonominë EPP"Jabllanica"-shoqatë e N.P." Pyjet e Maqedonis" është dhënë në tabelën që vijon:

Pasqyrë e detajuar e sipërfaqeve pyjore dhe pyjeve me të cilat zhvillon ekonominë e vet EPP "Jabllanica"-Strugë

Përshkrimi	[SE„Karaorman“	[SE„Jabllanica - Qafthan“	[SE„Jabllanica“	[SE„Globoçica“	Numri i p;rgjithshëm
Sipërfaqja e përgjithshme [ha]	5159, 40	7656, 90	5292, 90	5677, 80	23787
- prona të drujve	4665, 40	6923, 90	4786, 90	5134, 80	21511
- pyje private	494, 00	733, 00	506, 00	543, 00	2276
Sipërfaqja e përgjithshme [ha]	3541, 00	7069, 60	4737, 20	4156, 00	19503, 80
- pyje me drunjë të lartë	1054, 00	2943, 00	1931, 90	/	5928, 90
- pyje me drunjë të ultë	2487, 00	4126, 60	2805, 30	4156, 00	13574, 90
Sasia drurore [m³]	492765	749202	495873	224320	1962160
- pyje me drunjë të lartë	258705	443355	328277	/	1030337
- pyje me drunjë të ultë	234060	305847	167596	224320	931823
Rritja vjetore	10818	15187	8841	4101	38947
- pyje me drunjë të lartë	5653	8423	3481	/	17557
- pyje me drunjë të ultë	5165	6764	5360	4101	21390

Peshkataria dhe gjuetia

Liçeni i Ohrit posedon potencial të madh për zhvillimin e peshkatarisë në komunë, megjithatë gjuetia e pakontrolluar në të kaluarën ka rezultuar deri në zvoglimin drastik të fondit të peshkut të bardhë (trofta, bellushka-belvica) dhe ngjalës, të cilat paraqesin gjueti kryesore të liçenit. Aktualisht në fuqi është ndërprerja e gjuetisë së këtyre peshqëve, megjithatë edhe përkundër ndalesës këta peshq ende gjuhen në liçe. Numri i gjuajtësve të peshkut i regjistruar sillet rreth 30, por numri i personave të cilët gjuajnë peshk pa leje është shumë më i madh.

Lumi Sateska vazhdimisht sjell lym dhe shtresa, të cilat derdhen dhe i rrezikojnë dërrallat e troftës të pjesës Strugane të liçenit, me të cilat shkaktohet tërheqja e saj ose zhdukja nga kjo pjesë e liçenit. Përveç troftës në liçe ekzistojnë edhe krapi, cironka, mrena, kleni, grunecot, skobusi etj.

Në Komunën e Strugës funksionon edhe objekti për shtimin artificial të troftës që gjendet në fshatin Shum.

Për gjuetinë e peshkut karakteristike janë regjionet në rrjedhën e lumit Drini i Zi dhe në Liçenin e Gllloboçicës.

Në territorin e Komunës së Strugës ka katër regjione gjuetie, të cilët shtrihen në sipërfaqe rreth 35.000 ha. Nga kafshët e egra më i shpeshtë është derri i egër dhe egërsirat e tjera, por gjithashtu ka edhe maca të egra, kaprolle dhe rrëqebull, të cilat mbrohen me ligj dhe ndalohet gjuajtja e tyre. Në kuadër të regjioneve të gjuetisë funksionon qendra për reproduksion, e cila është një bazë solide për ripërtirjen e fondit të kafshëve të egra për gjueti. Ekonomizimi i sipërfaqeve për gjueti është dhënë me koncesion.

Turizmi

Komuna e Strugës është destinacion turistik që posedon me vlera turistike të afirmuara, të cilat paraqesin potencial të rëndësishëm turistik dhe aktivizimi i tyre duhet të jetë njëri nga imperativët e zhvillimit të përgjithshëm në periudhën e ardhëshme.

Adute më të mëdha të Komunës së Strugës, sa i përket zhvillimit të turizmit dhe hovit të fuqishëm të tij, në tregun ndërkombëtar të turizmit janë:

- Pozita e shkëlqyer gjeostrategjike dhe infrastruktura relativisht e zhvilluar e komunikacionit



- klima e mesme kontinentale dhe mesdhetare me shkallë të lartë të insolacionit gjatë tërë vitit
- fondi i pasur me florë dhe faunë me numër të madh të formave endemike,
- sipërfaqet me ambient natyror të ruajtur shkëlqyeshëm dhe ushqim të shëndetshëm,
- e kaluara e pasur historike me numër të konsiderueshëm të gjetjeve arkeologjike dhe përmendore kulturo-historike,
- masivet malore me kushte të jashtëzakonshme për zhvillimin e sporteve dimërore,
- tradita e shprehjes së fuqishme në kuadër të mikpritjes dhe folklorit etj.

Sezona kryesore turistike fillon nga mesi i muajit qershor dhe zgjat deri në fund të muajit gusht dhe fillim të muajit shtator. *Turizmi liqenor-rekreativ* është lloji më i zhvilluar i turizmit në komunë dhe ka kushte më të volitshme për zhvillim dhe afirmim të mëtutjeshëm.

Mundesitë për zhvillimin e *turizmit sportiv-dimëror* kanë të bëjnë me potencialet turistike në malin Jabllanicë, mbi bazën e tereneve të përshtatshme për ndërtimin e traseve për rrugica skijore, të rreshurat e borës dhe trashësia e saj.

Turizmi rural në komunë ka tendenca të zhvillimit, që don të thotë se duhet të krijohen kushte për zhvillimin e tij, definimin e vendbanimeve sipas vlerave të tyre natyrore, estetike, ambientale dhe me përgatitje përkatëse komunale që mund të llogariten si potencial në periodën e ardhshme.

Në rivierën e Strugës janë të vendosura kapacitete të rëndësishme hotelerike edhe atë: Hotel "Drim"-560 shtretër; Hotel "Biser"-260shtretër; Hotel "Eurotel" 1135 shtretër; Hotel "Skopje"-130shtretër; Hotel "Mak Petroll"-140 shtretër; Hotel "Beograd"-135 shtretër; Hotel "Galeb"-230 shtretër, Hotel "Rojal"-70shtretër; Hotel "Princ"-70 shtretër; Hotel "Klinton Pallas"-70 shtretër; Hotel "Diplomat"-110 shtretër; Hotel "Plazha" 64 shtretër; Hotel "Izgrev" -578

shtretër, Hotel "Gorna Belica"-50 shtretër; Pushimore për femijë "Majski Cvet"-600 shtretër, Hotel "Solferino" (Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit)-91 shtretër, Autokamp "As"-1600 shtretër, Autokamp "Livadishte" 1.200 shtretër, Autokamp "Treska"-350 shtretër.

Megjithatë, si rezultat i transformimit të kapitalit shoqëror, një pjesë e kapaciteteve hotelerike në disa vitet e fundit (në mënyrë periodike ose në kontinuitet) kanë qenë jasht përdorimit. Të tillë janë: Hotel Izgrev-578 shtretër; Hotel "Skopje"-130shtretër; Hotel "Plazha"-64shtretër; "Eurohotel"-1135 shtretër. Ndërprerja e punës së tyre është një humbje e madhe për ekonominë e komunës.



Kapacitete të vendosjes dhe të dhëna sipas numrit të shtretërve në Komunën e Strugës

Vjet.	gjithsej	kryesore	komplementare	individuale
1970	828	70	728	50
1980	8460	148	2414	3000
1991	12231	3619	6187	2425
1995	16298			

Pjesa më e madhe e vizitorëve të Strugës janë turistë të vendit, ndërsa pjesa më e madhe e turistëve të huaj, të cilët e vizitojnë Strugën vijnë nga vendet fqinje: Bullgaria, Greqia, Shqipëria dhe Kosova. Në sezonën jashtturistike më i shprehur është turizmi i ashtuquajtur i kongreseve.

Zhvillimi i turizmit në Strugë deri në pavarësimin e shtetit sillet me një dinamikë, kurse pas pavarësisë ky zhvillim bëhej përmes transformimit të kapitalit shoqëror, uljes së standardit jetësor të banorëve, konfliktit luftarak në vitin 2001 dhe veçanërisht konfliktet të cilët ndodhën në sipërfaqet e ish- Jugosllavisë, që ndikuan mjaft negativisht në zhvillimin e turizmit në vendin tonë dhe veçanërisht në Komunën e Strugës. Konstatimi i këtillë vërtetohet me zhvillimin e xhiros turistike të komunës deri në vitin 2001.

Ndërsa në pesë vitet e fundit vërehet trend pozitiv (në rritje) në krahasim me numrin e vizitorëve dhe numrin e buajtjeve në komunë, gjë që i përket stabilizimit politik të regjionit, begatimit dhe promovimit të ofertës turistike.

Zhvillimi i xhiros turistike në Komunën e Strugës

Vjet.	turistë		bujtjet	
	Gjithsej	Të jashtëm	Gjithsej	Të jashtëm
1968	9 122	809	85 915	2 838
1978	61 313	8 426	236 605	19 080
1988	103 160	12 287	567 683	63 609
1995	61 042	/	324 858	/

Oferta turistike në Komunën e Strugës duhet të inkorporojë një kualitet krejtësisht të ri, i cili do të jetë rezultat i percjelljes së zhvillimeve në tregun turistik ndërkombëtar, aprovimin e përvojave pozitive të destinacioneve të zhvilluara turistike dhe zhvillimin e barabartë të elementeve ekonomike, ekologjike dhe infrastrukturore. Para së gjithash është i domosdoshëm begatimi i ofertës ekzistuese me prodhime të reja dhe shërbime, zmadhimi i kapaciteteve të akomodimit dhe modernizimi i tërësishëm i këtyre kapaciteteve ekzistuese për vendosje, transformim themelor të sistemeve të udhëheqjes, parapërgatitje teknike-teknologjike dhe formësim urbanistik atraktiv funksional dhe përmbajtësor të elementeve atraktive të sipërfaqes.

Megjithatë, duke marrë parasysh prioritetet komparative dhe fuqinë tërheqëse të bukurive tona natyrore dhe atraktivitetet antropogjene, mund të presim që prodhimi turistik i Strugës i adoptuar drejt kërkesës specifike turistike dhe tërësisht i orientuar drejt segmenteve më parë të përcaktuara të tregut turistik, më në fund të fillojë të marrë fizionomi të vetë dhe imixh.

Në Komunën e Strugës funksionon Qendra Informatike Turistike, e cila është e organizuar në formë partneriteti të UNDP LDA-Strugë dhe Komuna Strugë. Qendra Informatike Turistike punon në promovimin e turizmit në komunë, ka bazë të përgatitur të të dhënave mbi kapacitetet e vendosjes në komunë, si dhe të kapaciteteve private të vendosjes. Janë botuar materiale promovuese për qytetin (udhëheqës turistik (ciceron), katalog të ofertës turistike, harta të qytetit dhe posterë dhe në kuadër të veprimtarisë së vet janë organizuar më shumë manifestime, sikundër janë Panairi i Parë i ofertës turistike, ekspozita të piktorëve lokalë, kuzhinë tradicionale dhe të mjeshtërve, prezentim të ofertës turistike për vitin 2006 etj.

1.2.4. Infrastruktura

Rrugët

Edhe pse e rrethuar me male të larta, Pellgu i Ohrit dhe Strugës është i lidhur mirë me rajonet e afërta dhe njëkohësisht është mirë i afrueshëm. Nga Shkupi deri në Strugë mund të arrihet përmes Kërçovës dhe përmes Manastirit-Resnjës –Ohrit në veriperëndim.

Përmes rrjedhës së lumit Drini i Zi, komuna është e lidhur me komunikacion me Pellgun e Dibrës. Në përfundim në drejtim të rrugës për Qafëthanë dhe rrjedhës së lumit Shkumbin Struga lidhet me Shqipërinë.

Në afërsi të Komunës së Strugës ndodhet gjithashtu edhe Aeroporti Ndërkombëtar.

Struga gjendet në pjesën jugperëndimore të Republikës së Maqedonisë dhe lidhet me sistemin e komunikacionit të shtetit përmes sistemit të zhvilluar të rrjetit rrugor.

Komuna lidhet me drejtimet rrugore nga brendia me Ohrin, Dibrën dhe drejt Republikës së Shqipërisë me kalimin kufitar Qafa e Thanës.

Të gjitha vendbanimet fshatare janë të lidhura me qytetin dhe pjesa më e madhe me rrugë të asfaltuara lokale, kurse të tjerat me rrugë të paasfaltuara (Malësia dhe Drim-

kolli). Punët ndërtimore janë kryer në një periudhë më të hershme kohore dhe të njëjtat janë të gjerësisë së pamjaftueshme për trafik dhe në një pjesë të konsiderueshme janë të dëmtuara.

Energjetika

Rrjeti distributiv elektrik në Komunën e Strugës furnizon mbi 22.000 shfrytëzues të kategorive të ndryshme përmes rrjetit të vet elektrik distributiv, që shtrihet në sipërfaqe rreth 520 km². Struktura e shfrytëzuesve të energjisë elektrike është e tillë që industria merr pjesë përgjithësisht me 30%, kurse shfrytëzuesit tjerë siç janë amvisëritë dhe shfrytëzuesit e përgjithshëm marrin pjesë me shfrytëzimin e tyre me 70%.

Në vitet e kaluara investimet sillleshin kryesisht në drejtim të sigurimit të objekteve elektrike të tensionit të lartë të rëndësisë parësore për furnizim burimor të konsumimit. U ndërtua trafostacion 110/35 (20)/10kV dhe dy trafostacione 35/10kV. Sot, me siguri të plotë teknike mund, të thuhet se objektet elektroenergjetike të shkallës së parë sipas prioritetit në procesin e distribuimit të energjisë elektrike, domethënë objektet e rangut më të lartë të tensionit, janë në gjendje fizike dhe qarkulluese të mirë dhe funksionojnë pa ndërprerje sipas regjimit qarkullues në kontinuitet.

Gjithashtu, në gjendje kualitative të regjimit të qarkullimit janë edhe rrjetet e tensionit të mesëm dhe largpërcuesit. Tani vëmendja është përqëndruar në drejtim të rrjetit elektrik të tensionit të lartë, të atij rrjeti elektrik nga i cili më për së afërmi furnizohen me energji elektrike amvisërië. Këtu problemi me furnizim të energjisë elektrike duhet të zgjidhet me ndërtim të numrit të madh të trafostacioneve distributive, kurse në të njëjtën kohë duhet të zgjerohen dhe rikonstruohen ato ekzistueset paralelisht me rritjen e kërkesave dhe nevojave.

Objekt qëndror dhe kryesor i tensionit të lartë për sipërfaqen distributive të konsumit "Struga" është trafostacioni 110/35 (20)/10kV, që ka kapacitet dhe i cili ndodhet në anën e majtë të lumit Drini i Zi në veri të rrugës regjionale Strigë-Qafëthanë. Ky trafostacion është kyçur 110kV-in e largpërcuesit Gllloboçicë-Ohër me 110 kV të dyfishtë DV me AL-Çe litar 150mm² me gjatësi prej 7, 2km.

Trafostacionet tjera elektrodistributive përmes të cilave furnizohen shfrytëzuesit me energji elektrike janë me numër 282, me fuqi të tërësishme elektrike të instaluar prej 158, 44 MVA. Rrjeti elektrik i cili lidhet me trafostacionet distributive është 792km. Nga kjo vetëm për ndriçimin e rrugëve përfshihen rreth 97km.

Hidroelektranat

Në territorin e Komunës së Strugës ndodhet një Central Hidroelektrik "Gllloboçica" që është pjesë përbërëse e shoqatës aksionare për prodhimin e energjisë elektrike në pronësi shtetërore "Elektranat e Maqedonisë" Shkup. Veprimtaria themelore e shoqatës është prodhimi i energjisë elektrike.

CH "Gllloboçica" është e ndërtuar në periudhën e viteve 1961-1965 dhe i shfrytëzon ujërat e derdhjes së lumit



Drini i Zi përmes akumulacionit "Globoçica".

Ndërtesat e makinerisë ku janë vendosur agregatët, dhoma komanduese, repartet ndihmëse dhe shpërndarësit ndodhen rreth 30 km larg nga Struga.

Furnizimi me ujë

Furnizimin me ujë të qytetareve të Komunës së Strugës, dërgimin e ujërave urbanë dhe industriale, pastrimin e tyre në stacionin për pastrim dhe ujërat jashtë përdorimit, i kryen Sipermarrrja Publike Ndërkomunale "Proaqua".

Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të ujësjellësit është 120.000 m. dhe tetë rezervuarë me gjithsej 2.210m³.

SPN "Proaqua" i ka furnizuar qytetarët e Komunës së Strugës me 1 569 212m³ ujë edhe atë, sipërmarrjeve 413 .296m³, kurse amvisërive 1. 155. 916m³.

Furnizimi me ujë bëhet përmes tubimit të disa burimeve të vendosur nën shtetullën e malit Jabllanica. Këta burime disponojnë me ujë të shëndetshëm dhe kualitativ për pije.

Për mirëmbajtjen sanitare të ujit kujdeset ekipi i "Proaqua-s", i cili e bën dezinfektimin permanent të ujit me klor të lëngët dhe të gazuar. Kontrollimin për gjendjen e kënaqshme të ujit për pije e bën Enti Republikan për mbrojtje shëndetësore nga Ohri.

Kanalizimi dhe sistemi i kolektorit

Ujërat e ndotura, të cilët formohen nga amvisëritë dhe industria përmes kanalizimeve sekondare, lëshohen në kolektorin primar dhe arrijnë në stacionin pastrues për ujëra të ndotur, ku pastrohen deri në një shkallë të caktuar dhe lëshohen në lumin Drini i Zi.

Në sipërfaqen e Komunës së Strugës ka një stacion pastrues të tubimit dhe gjashtë stacione pompa në rrjet tërësor prej 14km.

Me sistemin e kolektorit nuk është përfshirë vetëm pjesa e vendbanimit Guri i Drrit deri tek fshati Radozhde. Stacioni pastrues i tubimit mund të pranojë dhe të përpu-

nojë 40. 000 m³ujë në ditë.

Me kolektorin primar të stacionit pastrues të ujërave të ndotur transportohen 941. 566m³ ujëra të ndotura për një vit.

Kualiteti i ujërave të lëshuara përcillet dhe kontrollohet në laboratorin e vendosur në stacionin e pastrimit dhe u pergjigjet standardeve të Unionit Europian për kualitetin e ujërave të ndotura të pastruara, të cilat lëshohen në rrjedhat natyrore të ujit.

Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të kanalizimit është 1.268.553 m³. Me kanalizim dërgohen 872.950 m³ në vit, ose 55, 6% të ujit të plasuar edhe atë, sipërmarrjeve 297 .562 m³, kurse amvisërive 575. 389 m³.

Telekomunikacioni

Telefoninë fikse e sigurojnë Telekomunikacionet e Maqedonisë përmes njësisë së vet punuese në Strugë.

Territorin e perfshinjë dy operatorë të celularëve dhe provajderët e Internetit nacional. Të tjerat janë kompani lokale, të cilat ofrojnë internet kabllovik dhe jokabllovik.

Amvisëria dhe planifikimi urbanistik

Komuna e Strugës ka 14.485 amvisëri me mesatarisht 3, 5 anëtarë për familje. Nga ato 96.5% janë të pajisura me instalim të ujësjes, kanalizim dhe rrymë.

Në pjesën e urbanizuar të Komunës së Strugës janë aprovuar plane urbanistike gjenerale dhe plane detale urbanistike për njësitë urbanistike. Shumica e tyre janë azhuruar (zbatuar me kohë) në periudhën e viteve 2000/2005. Tani në fazë finale të përpunimit janë planet urbanistike të brezit buzë liqenit. Vendbanimet rurale janë të rregulluara mbi bazën e dokumenteve urbanistike për vendbanime dhe me akte të tjera, të cilat i zëvendesojnë planet urbanistike. Po të njëjtat janë të periudhës së viteve 1991-2000.

Sipas të dhënave të vetëqeverisjes lokale Komuna e Strugës ka përqindje të vogël të ndërtimeve të egra.

1.3. Profili social

1.3.1. Arsimi

Arsimi në Komunën e Strugës zhvillohet në tri gjuhë mësimore (maqedonisht, shqip, turqisht).

Në procesin arsimor është përfshirë e tërë popullata nga të gjitha nacionalitetet, me përjashtim të një numri të vogël të popullatës rome.

Në sektorin arsimor të komunës punojnë gjithsej 811 persona. Përgatitja përkatëse e kuadrit arsimor është e kënaqshme.

Në Komunën e Strugës arsimi zhvillohet në nivele të këtitilla me sa vijon:

- 1 (një) ent parashkollor,
- 11 (njëmbëdhjetë) shkolla fillore dhe 24 njësi të shpërndara,
- 1 (një) shkollë e mesme shtetërore me këto drejtime: ndërtimtari, gjeodezi, kimi-teknologji, shëndetësi, ekonomi, drejtimi i tekstilit dhe lëkurës dhe gjimnazi. Në kuadër të qendrës së mesme shkollore gjëndet një internat për vendosje të nxënësve me më shumë se njëqind shtretër dhe me mundësi për t'u ushqyer në formë pansioni,
- 2 (dy) shkolla të mesme private
- 1 (një) institucion i lartë arsimor
- Në komunë punojnë dy paralele për persona me pengesa të lehta, të mesme dhe të kombinuara dhe një Qendër Ditore për fëmijë me nevoja të posaçme, të cilën e vizitojnë persona me pengesa (?) të mesme dhe të kombinuara.

Rreth 20% e nxënësve, të cilët e mbarojnë arsimin filor, regjistrohen në shkollat e mesme jasht komunës.

Në vitin shkollor 2005/2006 janë regjistruar 8.076 nxënës në shkollat fillore, 2.700 janë regjistruar në shkollën e mesme shtetërore "Niko Nestor" dhe 120 nxënës në shkollën e mesme private.

Në krahasim me vitin 1998 ky numër është zvogëluar, kështu që në vitin 1998 numri i nxënësve të regjistruar në shkollat fillore ka qenë 10.000 filloristë. Zvoglimi i numrit është rezultat i shkuarjes familjare jasht vendit.

Në shkollën e mesme mesojnë edhe nxënës nga qytetet fqinje: Ohër, Dibër, Resnjë dhe nga Vevçani.

1.3.2. Shëndetësia dhe mbrojtja sociale

Shëndetësia

Mbrojtja shëndetësore në territorin e Komunës së Strugës realizohet përmes veprimtarisë së katër organizatave shëndetësore publike (Shtëpisë së Shëndetit, Spitalit të Përgjithshëm, Entit për Nefrologji dhe Shtëpisë së Shëndetit në Vevçan). Në territorin e komunës gjenden edhe dymbëdhjetë ordianca private të mbrojtjes shëndetësore primare, dy ordianca private për mbrojtje shëndetësore specialistike, pesëmbëdhjetë ordianca private stomato-

logjike dhe gjashtëmbëdhjetë barnatore private.

Mjeku personal zgjidhet sipas dëshirës së qytetarëve, ndërsa për fëmijet e moshës deri në 14 vjeç zgjedhjen e mjekut mund ta bëjë edhe prindi.

Me Ligjin e Ri për Decentralizim një pjesë e shëndetësisë, e ashtuquajtura shëndëtsi primare, nga viti 2007 duhet të kalojë në kompetenca të vetëqeverisjes lokale, me të cilën qytetarët ballafaqohen fillimisht gjatë kërkesës së tyre të shërbimeve shëndetësore. Në kuadër të vetëqeverisjes lokale Komuna e Strugës do të ishte organizatë e re shëndetësore, e ashtuquajtur OPOSH (Organizatë Publike Shëndetësore) Shtëpi Shëndeti- Strugë, në pajtim me normat ligjore, si bartës të mbrojtjes shëndetësore primare të qytetarëve, të cilët jetojnë në territorin e Komunës së Strugës.

OPOSH Strugë ka ambulanca në tetë fshatra.

OPOSH Shtëpia e Shëndetit Strugë veprimtarinë shëndetësore e zhvillon nëpër njësitë organizative: Mjekësia e Përgjithëshme me ndihmën e shpejtë mjekësore; Gjinekologjia dhe Akusheria; Patronazha Polivalente; Sëmundje; Vaksininim; Këshillimore; Mjekësia Shkollore; Mjekësinë e Punës; Dispanzerin e Antituberkulozës; Mbrojtjen Stomatologjike; Depon e barnave.

Gjithsej të punësuar në OPOSH në Shtëpinë e Shëndetit në Strugë janë 142.

Fondi për Sigurim Shëndetësor i Maqedonisë ka lidhur kontratë me dymbëdhjetë organizata shëndetësore private në nivel të Komunës së Strugës.

Mbrojtja Sociale

Enti Publik, Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale në Strugë është i vetmi institucion i Komunës së Strugës, që ushtron politikë sociale dhe mbrojtje të banorëve. Në kuadër të qendrës punojnë më tepër shërbime për ushtrimin e mbrojtjes sociale edhe atë:

- Shërbimi për donacione materiale (ndihmë të vazhdueshme sociale dhe në para), vendosje në familje tjera, perkujdesje të të tjerëve dhe ofrime të veçanta);
- Shërbimi për raporte të rrënuara martesore (shkurorëzime dhe takime prind-fëmijë) ndërmjetësim për pajtim, dhunë familjare.
- Shërbimi për delikuençë fëmijërore (kryes të veprave për kundravajtje prej 14-18 vjeç).
- Shërbimi për përvehtësim të fëmijës dhe perkujdesje ndaj fëmijëve të cilët kanë mbetur pa të dy prindët dhe perkujdesje ndaj personave të rritur.
- Shërbim për veprimtari të përgjithshme dhe të përbashkëta
- Shërbim për ndarje të shtesës fëminore

Pranues të parave dhe forma të tjera të ndihmës mbi bazën e kërkesave të ndryshme në vitin 2005

Pranues të ndihmës sociale në para	1449
Pranues të ndihmës së përhershme në para	59
Shtesë për përkujdesje të huaj	336
Ndihmë njëkahëshe në para	859
Persona të vendosur në shtëpi-familje	6
Raste të dhunës familjare	3
Shfrytesues të shtesës feminare	525 persona/1.186 fëmijë
Ndihmë në përtgatitje për foshnjë	252

* Burimi : Qendra për punë sociale Strugë

Në përkujdesjen sociale për persona të kategorisë specifike bëjnë pjesë pleqë të pasiguar në aspektin material, ose të paafte për punë dhe persona pa përkujdesje familjare.

Në vitin 2005 numri i këtyre personave ishte 60. Kategori të posaçme janë fëmijët me nevoja të veçanta -130 fëmijë. Kjo kategori e fëmijëve janë shfrytëzues të shtesës së veçantë, të cilën e marrin përmes prindërve të tyre.

Në Strugë gjendet Qendra për Fëmijë me nevoja të posaçme, e cila financohet nga Qeveria Finlandeze deri në fund të vitit 2006.

Për kategorinë e personave me sjellje asociale (të varur nga

droga, alkooli) ende nuk është gjendur zgjidhje përkatëse. Nuk ekziston qendër për përkujdesjen e këtyre personave.

Numri i lypësve veçanërisht në sezonën verore është në rritje të vazhdueshme dhe për këtë duhet të ndërmerren masa për t'u zgjidhur

Mbrojtja dhe shpëtimi i qytetarëve, kafshëve, bimëve dhe të mirave materiale

Për sigurinë dhe rendin publik dhe qetësinë në Komunën e Strugës kujdeset njësi për punë të brendshme –MPB Strugë. MPB Strugë ka edhe katër njësi rajonale në fshatrat: Frëngovë, Veleshtë, Dollogozhdë dhe Llukovë.

Gjendja lidhur me rendin publik dhe qetësinë në qytet është e kënaqshme. Shkaqe më të shpeshta të prishjes së rendit publik janë çështjet e pazgjidhura pronësore-juridike, kurse në sezonën turistike si shaktarë merren konsumimi i alkoolit nga të miturit, dëmtimet në kohën e punës e të ngjajshme.

Ekziston edhe disa agjencione privat për sigurimin e pasurive dhe personave.

Njësia e Zjarrfikësve-Strugë e përfshin territorin e Komunës së Strugës dhe Vevçanit. Është vendosur në rrugën magjistrale Strugë –Qafë e Thanës dhe ka në përdorim katër makina për zjarrfikje.

Qendra për lajmërim dhe alarm mban përgjegjësi për

zbulim dhe preventive, për pasojat nga katastrofat natyrore, epidemitë dhe shkaqe të tjera të katastrofave, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, të pasurive natyrore dhe të vlerave kulturoro-historike në gjendje paqeje dhe lufte.

1.3.3. Kultura

Vlerat antropogjenike

Si motiv turistik më i rëndësishëm në grupin e antropogjenëve janë motivet turistike kulturo-historike. Për kulturën historike të Strugës dhe të rrethinës vërehen gjurmë qysh nga periudha e neolitit. Vlerat e zbuluara në brigjet e lumit Drin dhe në vet bregun e liqenit, dëshmojnë se që nga neoliti e këndej Struga ka qenë vendbanim.

Në periudhën e mëvonshme, për epokën greko-romake, dëshmohet se në Strugë dhe rrethinë është zhvilluar një jetë kulturore intensive që karakterizohet me mbeturina të pjesëve nga komunikacioni tregtar romak "Via Ignatia". Nga koha e periudhës së hershme kristiane rëndësi të veçantë kanë bazilikat në fshatin Ladorisht dhe në fshatin Oktis, kurse nga perioda pararomake nekropoli në fshatin Dollogozhdë.

Interesante dhe shumë të rralla janë kishat e shpellave, të cilat gjenden në regjionin e Strugës.


Jeta kulturore e cila zhvillohej në periudhën turke gjithashtu ka lënë gjurmët e veta në Strugë dhe rrethinë. Në Strugë ka tempuj islamikë dhe ndërtime arkitektonike religjioze, të ndërtuara në kohën e Perandorisë Otomane në Maqedoni.

Në grupin e motiveve kulturo-historike përveç të lartpërmendurave duhet të përmenden edhe përmendoret e kulturës dhe shënimet përkujtimore, institucionet nga lemitë e kulturës, muzetë, galeritë, manifestimet kulturore, letrare, muzikore dhe krijimet e artit figurativ.

Pranë Qendrës për Kulturë "Vëllezërit Milladinovci" në Strugë punon edhe Biblioteka Popullore "Vëllezërit Milla-diovci"

Institucione të rëndësishme kulturore janë edhe Shtëpia Përkujtimore e Vëllezërve Milladinovci, Galeria e Artit Figurativ e Vangjel Koxhomanit, Muzeu Shkencor-Natyror Dr. Nikolla Nezlobinski".

Manifestimi më i njohur është Festivali Botëror



“Mbrëmjet Strugane të Poezisë”, që mbahet tradicionalisht çdo vit në datat 25-29 gusht.

Fillimet e këtij festivali datojnë që nga viti 1961, me rastin e përvjetorit të vdekjes së Vëllezërve Milladinovci, kur është botuar edhe libri i tyre “Bleni” (Zbornik).

Nga manifestimet tjera kulturore më të rëndësishëm janë: Vjeshta Muzikore Strugane (përkthim), Revyja e Veshjeve Popullore, Kënge Jeho, Ditët e Goces, Konakët Maqedonë të Mençurisë, të cilat tradicionalisht mbahen çdo vit.

Gjuha

Karakterit multi-etnik i Komunës së Strugës është shprehur në gjuhët. Komuna e Strugës është komunë multigjuhësore në të cilën fliten këto gjuhë: Gjuha Maqedone, Shqipe, Vllahe, Turke, Serbe, Rome.

Gjuhë zyrtare në të cilat zhvillohet komunikimi institucional lokal janë Gjuha Maqedone dhe Gjuha Shqipe.

1.3.4. Sport

Në Komunën e Strugës janë aktivë klubet sportive në keto disiplina të sportit: volejball, basketboll, ping-pong, boks, karate, kajak-kanu, vaterpolo, shah, paraglajding (fluturim me delta plan), veltari, rremtari dhe jogë (joga).

Analiza e gjendjes së objekteve të sportit dhe kulturës fizike në komunë dëshmon qartë, se nga gjithsej 121 objektet, pjesa më e madhe janë fusha sportive të hapura. Shumica e tyre u takojnë objekteve të kategorisë së tretë për shkak të jofunksionalitetit.

Vetëm një numër i vogël i takojnë klasës së parë e të dytë, edhe atë kryesisht objektet me të cilat disponojnë organizatat turistike.

Këto objekte në pjesën më të madhe janë pronë e klubeve sportive, një pjesë janë të organizatave hotelierike, pastaj të shkollave dhe një pjesë e vogël janë të sipërmarrjeve publike.

Sipërfaqja e përgjithëshme shfrytëzuese e tyre është rreth 200.000 m², duke llogaritur edhe sipërfaqet që janë objekte përcjellëse të atyre themeloreve, që don të thotë se mesatarisht çdo banori të Strugës i takon nga 3 m².

Këto vlera nuk u takojnë të ashtuquajturve objekte të mbyllur, salla sportive, pishina e të ngjajshme.

1.3.5. Sektori i OJQ-ve

Regjioni i Strugës e ka këtë strukturë të OJQ-ve të kategorizuara sipas qëllimeve të përgjithëshme: mbrojtja e ambientit-12; edukim i gruas-7; të drejtat e njeriut, demokracia dhe kultura-15; arti figurativ, kultura-6; për persona me nevoja të posaçme-6; humanitare-4; sport-2; punë sociale-2; të tjera-15.

Prej gjithsej 69 organizatave joqeveritare në Strugë vetëm një pjesë e tyre posedojnë kushte themelore për veprimtari, lokal, përgatitje adekuate dhe potencial njerëzor.

Organizatave joqeveritare të këtij regjioni kanë nevojë të parapërgatitjes së vazhdueshme dhe të përgatitjes profesionale.

Problemi më i madh që shfaqet tek këto OJQ është ajo

që nuk janë të profilizuara mjaftueshëm, nuk kanë bashkëpunim të mirë, nuk janë të përgatitura për lobim dhe për tu prezentuar, financiarisht qëndrojnë dobët dhe shumë shpesh ndodh që të zhvillojnë aktivitete, që nuk janë në përputhje me misionin e tyre dhe qëllimin për të cilin janë ngritur. Gjendja e këtillë jep pasqyrë të papëlqyeshme për sektorin joqeveritar në regjionin tonë, duke lënë përshtypje të një sektori të paorganizuar dhe kështu automatikisht sektori joqeveritar nuk e ka peshën përkatëse si shtyllë e tretë në shoqëri (sektori i biznesit dhe politika).

Qendra për përkrahje të OJQ-ve në Strugë e zhvillon veprimtarinë në kuadër të shoqërisë qytetare, duke dhënë kontribut në ndërtimin e sektorit civil në regjionin e Strugës, Ohrit dhe Vevçanit.

Qendra u mundëson OJQ-ve në tejkalimin e vështirësive teknike, në ofrimin e mundësive për informim dhe bashkëpunim me OJQ- të tjera në gjithë territorin e Maqedonisë.

1.3.6. Mediumet

Në Komunën e Strugës egzistojnë dy stacione televizive TV Kaltrina dhe Art Kanal, katër radio stacione (Biser Radio, Dixhej Radio, Radio Struga dhe Radio Rrapi) dhe qendra raportuese për mediumet e shtypura dhe televizionet më të mëdha.

1.4. Zhvillimi rural

Zhvillimi rural është i rëndësishëm të veçantë për zhvillimin e përgjithshëm të Komunës së Struges, sepse pjesa më e madhe e Strugës është rurale. Në Strugë ka më shumë qendra rurale që i kanë atributet e vendbanimeve të urbanizuara, të cilat në të ardhmen mund të jenë gjeneratore të zhvillimit të mikro- regjioneve rreth tyre.

Por, hapësirat rurale ballafaqohen me probleme të mëdha për një kohë më të gjatë edhe atë:

Bashkësi lokale jofunksionale, migrim të banorëve në qytete dhe jasht vendit, mungesë të stimulimit nga ana e pushtetit, mospasje të blerjes së organizuar të prodhimeve bujqësore, mungesë organizimi të bujqëve, probleme me infrastrukturën nëpër fshatra, pakujdesi ndaj fondit të pyjeve dhe mungesë informimi për teknologjitë e reja në këtë sferë. Është e evidente ndryshueshmëria në lidhje me zhvillimin ndërmjet qendrave rurale dhe vendbanimeve rurale Malesi dhe Drimkol. Karakteristike është sepse ato janë shumë pak të populluara nga pikëpamja e infrastrukturës, janë të parregulluara dhe nuk kanë aktivitete afariste.

Potencialët për zhvillim njihen përmes prodhimit bujqësor ekologjik dhe turizmit të fshatit. Por, në periodën e ardhshme duhet t'i kushtohet më shumë kujdes stimulimit, organizimit dhe edukimit të bizneseve të vogla, të cilat ekzistojnë në hapësirat rurale.

1.5. Bashkëpunimi regjional

Komuna e Strugës ka bashkëpunim të suksesshëm shumëvjeçar me komunat fqinje – Ohrit dhe Pogradecin (R. e Shqipërisë). Fushat kryesore të bashkëpunimit janë

mbrojtja e Liqenit të Ohrit dhe zhvillimi përpara i eko-sistemit.

Njëzet e një qershori është përcaktuar si Ditë e Liqenit, të cilën bashkërisht e festojnë të tri qytetet.

Komuna e Strugës gjithashtu është anëtare e Euro-regjionit Ohër-Prespë, në kuadër të të cilit zhvillon bashkëpunim me komunat në trekëndëshin mes R. së Maqedonisë, R. së Shqipërisë dhe R. së Greqisë.

Në përpunim e sipër është strategjia për zhvillim regjional të njësisë statistikore jugperëndimore, në kuadër të së cilës është edhe Komuna e Strugës.

1.6. Kompetencat e Komunës


Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale "Komuna" është njësi e vetëqeverisjes, si bashkësi e qytetarëve të një territori të caktuar e përcaktuar me ligj, e cila përmes organeve të veta dhe përmes administratës dhe shërbimeve të organizuara publike, mundëson kryerje të kompetencave të përcaktuara me ligj. Komunat janë persona juridik dhe kompetencat e tyre i kryejnë përmes organeve të zgjedhura nga ana e qytetarëve.

Rregullat e Komunes :

- Komuna e rregullon kryerjen e kompetencave të veta me statut dhe akte tjera.
- Me statutin e komunës rregullohen:
 - organizimi dhe funksionimi i organeve të komunës, organizimi dhe funksionimi i komisioneve të keshillit;
 - kryerja e veprimtarive sipas nenit 20 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, mënyra e informimit të qytetarëve;
 - rastet që përjashtojnë publikun nga mbledhjet e Këshillit;
 - mënyrën dhe ecurinë e dorëzimit të ankesave dhe propozimeve për veprimtarinë e organeve të komunës dhe veprimin sipas tyre;
 - mënyrën e organizimit të tribunave publike, zbatimin e anketave dhe tubimin e propozimeve të qytetarëve;
 - mënyrën e kryerjes së obligimeve nga fusha e mbrojtjes në gjendje lufte, si dhe çështje tjera me rëndësi për vetëqeverisjen lokale.
 - Dispozitat e komunës publikohen para se të hyjnë në fuqi.
- Mënyra e shpalljes së dispozitave është rregulluar me Statut.
- Komuna ka stemën e vet dhe flamurin.

Komuna ka kompetenca për kryerjen e veprimtarive me sa vijon:

- Planifikimin urbanistik (urban dhe rural)
- Mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës
- Zhvillimin e ekonomisë lokale
- Veprimtaritë komunale
- Kulturën
- Sprotin dhe rekreimin
- Mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve
- Arsimin
- Mbrojtjen shëndetësore
- Zbatim, përgatitje dhe ndërmarrje të masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale
- Mbrojtje nga zjarret përmes njësisë zjarrefikëse territoriale
- Mbikqyrje rreth zbatimit të veprimtarive nga kompetencat e komunës
- Veprimtari tjera të përcaktuara me ligj



Buxheti i Komunës së Strugës

Të hyrat dhe të dalat e komunës vërtetohen me buxhetin e komunës.

Buxheti i komunës përmban bilansin e të hyrave dhe të dalave, por që i takojnë vitit fiskal për dymbëdhjetë muaj, që fillon nga një janari, kurse përfundon në tridhjetenjë dhjetor të çdo viti kalendarik.

Buxheti i komunës para miratimit përshtatet (barazohet) me Ministrinë e Financave në pjesën për kërkesat dhe mundësitë për marrje hua nga buxheti i Republikës për financimin e deficitit buxhetor.

Propozimi i buxhetit të komunës vërtetohet nga prefekti dhe dërgohet në Këshillin e komunës për miratim në muajin nëntor të vitit në vijim.

Buxheti i Komunës së Strugës për vitin 2006:

TË ARDHURA BUXHETORE	411.034.841	%
TË ARDHURAT TATIMORE	173.784.000	42.27
TË ARDHURA JOTATIMORE	7.695.000	1.87
TË ARDHURA NGA KAPITALI	150.700.000	36.66
TRANSFERET DHE DONACIONET	78.855.841	19.18
DALJET	411.034.841	
RROGAT, TE DHENA DHE KOMPENZIME TE TE PUNESUARVE	40.038.190	9.74
REZERVAT DHE DALJE TE PADEFINUARA	556.000	0.13
MALLRAT DHE SHERBIMET	194.535.651	47.32
TRANSFERE VIJUESE DERI TE NJESITE E VETEADMINISTRIMIT LOKAL	1.300.000	0.52
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	23.600.000	5.74
BENIFICIONET SOCIALE	200.000	0.04
KAPITALE DALESE	150.805.000	36.51

2. SWOT



NFRAS TRUK TURA

ANËT E FORTA

Rrjetë rrugor të mirë nacionale dhe internacionale
Rrjetë i zhvilluar rrugorë ndërmjet fshatrave dhe qyteteve

7 km prej Aeroportit të Ohrit, 200km prej Aeroportit të Shkupit.

3 orë deri në Detin Adriatik (Durrës-Shqipëri)

Terminal të mire doganor në qytet dhe dhe mbi dhjetë kilometra largesi nga kalimi kufitar me Shqipërinë.

Rrjetë i zhvilluar i linjave të autobusëve në vend dhe jasht

Transport të mire taxi.

40 km largesi nga hekurudha në Pogradec, Shqiperi dhe gjashtedhjetë kilometra nga Kerçova

Rrjetë elektrike të kompletuar në vendet rurale dhe urbane

Rrjetë kanalizimi në vendbanimet e bregut të liqenit

Rrjetë ujeshjëllësi në të gjitha vendet e banuara

Rrjetë telefonike deri në të gjitha vendet e banuara

Plane urbanistike

Kadaster funksional

ANËT E DOBËETA

Mungesë e rrjetit rrugor në disa vendbanime rurale

Mungesë e vendeve për parking

Mungesë e sinjalizimit të komunikacionit (horizontale dhe vertikale)

Ndriçim i dobët i rrugëve të lagjeve

Drurit si burim kryesor për ngrohje

